



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 176, Datë 28-12-2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 24.11.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 24.11.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 24.11.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 24.11.2022

Kryesuesi i mbledhjes është Kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 27

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 27 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo, Zv Kryetar i Bashkisë z.Kletjon Kita dhe drejtorë të ekzekutivit.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 4

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Meqënëse shumica e këshilltarëve janë prezent , në lidhje me rendin e ditës ka diçka? Ekzekutivi ka diçka me rendin e ditës? Nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJES SË DATËS 27 TETOR 2022.(me e-mail)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE,DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 TETOR2022.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)znj.Irena Nikaj.

Këshilltare znj.Irena Nikaj:Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social, Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK.Për periudhën tetorjanë 53familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune,personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë,familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022.Për muajin Tetor 2022, është në dispozicion fondi prej 263.210 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike , nga sistemi i pikëzimit.Nga kyfond, përfitojnë 53 familje,të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 175.447 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 24 familje, në shumën30.264lekë. Pagesa totalenga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji,është 205.711 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike ngafondi i buxhetit vendor ,sipas kriterëve specifike të miratuara 12 familje, me fond prej 43.994lekë me përcaktimet persona të vetmuar, familje me shumë fëmijë, persona në pamundësi fizike për të punua, kryefamiljare femra me fëmijë të mitur në ngarkim, kryefamiljar mbi moshë pune 0,familje të komunitetit rom-egjiptian, me probleme dokumentacioni . Ndoshta të miratohen kriteret në mënyrë që këto 0, që të ketë familje të tjera që të trajtohen, që të përfitojnë , mund të kenë nevojë për ndihmëedhe pa bërë pjesë në këto kategori. Mund ta shikoni këtë, unë i propozoj Këshillit Bashkiak miratimin e kësaj ndihme ekonomike qëështë parashikuar për këtë muaj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Faleminderit nga ekzekutivi ka diçka ?

Ekzekutivi A.Vranishti: Nuk ka pasur kërkesa për këto kategori pasi janë përfshirë përfitues direkt nga sistemi i pikëzimit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra kanë fituar nga njëra anë dhe nuk mund përzgjidhen.

Këshilltare I.Nikaj: Të shtohen kategoritë.

Ekzekutivi A.Vranishti: Nuk ka pasur kërkesa, nëse ka kërkesa ne patjetër sepse fonde ka

Këshilltare znj.Irena Nikaj: Prandaj them që ndoshta të shtohen kategori të tjera që të përfshihen edhe këto familje, nuk kemi familje me shumë fëmijë apo mbi moshë, por ka kategori të tjera që mund të ndihmohen dhe të mos jetë e kursyer.

Ekzekutivi A.Vranishti: Në kriteret që do të miratohen çdo fillim viti do rishikohen.

Këshilltare znj.Irena Nikaj: Ndoshta dhe ju mund të zgjidhni mbi bazën e problematikës apo dhe të tjerë ta kenë parasysh që të ndihmohen sa më shumë njerëzit.

Ekzekutivi A.Vranishti: Doja të shtoja dhe diçka që për familjet e muajit tetor që do miratojmë sot me një vendim të Këshillit të Ministrave pagesa për disa kategori të familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike dyfishohet dhe trefishohet ndihma ekonomike dhe rritet me 10% për pjesën tjetër të familjeve përfituese.

Këshilltare E.Tare: Numri i familjeve përfituese që futen tek 6% është i kufizuar apo mund të aplikojëçdokush sepse nga informacionet që kam dhe nga shqetësimet që kanë erdhur nga qytetarët më thuhet që është një numër i kufizuar.

Ekzekutivi A.Vranishti: Jo për t'u trajtuar më fondin 6% janë disa kriteret që janë miratuar çdo fillim viti nga Këshilli Bashkiak dhe patjetër që duhet ti përmbahemi këtyre kriterëve dhe limit patjetër që ka , sepse fondi që vjen për tu trajtuar me 6% është një fond që vjen nga sistemi i pikëzimit dhe vjen nga drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror dhe ne do ti përmbaheni atij fondi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Cështja është sot që flasim ky muaj, kërkesat kanë qënë më të mëdha se fondi dhe ka familje të përjashtuara nga kjo skemë për shkak se nuk plotësoheshe fondi apo kaq ishin kërkesat ?

Ekzekutivi A.Vranishti: Kaq ishin kërkesat.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Patjetër që ka një limit.

Kryetari i bashkisëS.Filo: Limiti është me fond, nuk është me numër.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra po qe se shtohet numri thjesht ulet vlere për familje si i bie?

Ekzekutivi A.Vranishti: Jo nuk ulet vlere, vlere është njësoj.

Kryetari i BashkisëS.Filo: Vlere është e përcaktuar.

Ekzekutivi A.Vranishti: Është me formulë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Sipas zonjës ishte që ka pasur kërkesa dhe i është thënë që është plotësuar fondi.

Këshilltare E.Tare : Edhe pse i kanë përmbushur kriteret, kërkesa ka patur, i kam parë vetë dokumentacionin nuk janë pranuar sepse kanë patur një limit të caktuar.

Ekzekutivi A.Vranishti: Këto duhet të ishin adresuar tek ne.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakord por nuk ka ndodhur që të kemi kërkesë dhe të përjashtohet për shkak të fondit. Sqaroje mirë këtë. Atëherë shikoje rastin konkret.

Ekzekutivi A.Vranishti: Kur të vijë rasti patjetër në bazë të kriterëve ne nuk përjashtojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Edhe njëherë po qe se çështja është siç thotë Etleva është situatë.

Këshilltare E.Tare : Mund të themi që e kemi nga njësia administrative e drenovës.

Këshilltare A.Verushi: Etleva thotë ka por s'ka fond.

Këshilltare E.Tare: Unë kam kontaktuar dhe më kanë thënë që unë e kam numrin e kufizuar. Me sa kam parë unë fondi ka ngelur dhe kanë thënë që s'ka kërkesa, ndërkohë qëkërkesa ka patur, dokumentacionin e kanë pasur të rregullt dhe nuk është miratuar.

Kryetari i BashkisëS.Filo: Tani problemi është se po flasim për një rast hipotetik pa ja parë letrat. Tani dakord pra ti thua e kam pare ka qënë në rregull, punonjësi i drejtorisë së kujdesit social thotë që në rastet që kanë qënë në rregull me kërkesat nuk ka ngelur asnjë pa u trajtuar. Tani rasti konkret me emër me mbiemër me dosje ta verifikojmë dhe ta shohim si është.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani mund ta shikoni bashkë rastin.

Sekretare E.Naçi: Do të doja t'ju lutesha këshilltarëve të marrin pjesë në mbledhjen e komisioneve. Këshilltare Etleva është pjesë e komisionit dhe në komisionin e çështjeve sociale vjen vetëm këshilltare Irena Nikaj ndërkohë që mund të vijë dhe ti shpjegojë të gjitha këto probleme që kanë paraprakisht përpara se të vijë materiali për miratim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Gjithësesi dhe sot nuk është vonë ta shikoni këtë rast. E votojmë materialin po qe se është diçka se ti thua që nuk ka pasur probleme fondi pavarësisht qëështë i përcaktuar në numër nuk kemi pasur situatën që ka kërkesë plotëson kriteret patjetër që fondi është i kufizuar.

Këshilltare I.Nikaj: Na duhet që personat që përfitojnë të kenë paraqitur nga një akt administrativ.

Ekzekutivi A.Vranishti: Ky rast nukështë paraqitur në dijeninë time.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Shikojeni pak ju lutem, ka diçka tjetër për këtë material?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË BASHKIMIT TË TRE QËNDRAVE QË OFROJNË SHËRBIMET PAK NË NJË QËNDËR "NJËSIA E SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA PAK" NË BASHKINË KORÇË.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znjIrena Nikaj.

Këshilltari I.Nikaj: Atëherë në relacionin që është paraqitur parashtrohet nevoja dhe kërkesa për të administruar më mirë në terësi Shërbimin shoqëror që ofrohet nga 3 qendra të cilat janë qendra zhvillimi, qendra ditore e zhvillimit, qendra komunitare, qendër e zhvillimit rezidencial dhe qendra komunitare për fëmijët me aftësi ndryshe. Në relacion është shpjeguar dhe mënyra si funksionon dhe kostoja e shërbimeve që ato shpërndajnë dhe është treguar se ato kanë nevojë për një organizim më të mirë dhe me efikasitet më të lartë për të realizuar qëllimet për të cilat funksionojnë por edhe për të përdorur më mirë mjetet financiare që përdoren. Kështu që nga analiza që i është bërë propozoj bashkimin e 3 institucioneve në kuptimin e administrimit dhe ato do të funksionojnë si një njësi e vetme e mëvetësishme e varur nga bashkia, pra bashkia merr përsipër që të realizojë më mirë shërbimet që ofrojnë këto qendra duke përdorur më mirë dhe paratë e taksapaguesve. Në relacion parashtrohen të gjitha ato cilësi që merr përsipër t'ju shtojë shërbimeve që jep qendra përmes administrimit nga ana e bashkisë. Disa ndryshime që shoqërojnë këtë ndryshim të administrimit janë që ngrihet një institucion në varësi të bashkisë me emërtimin njësi e shërbimeve tëspecializuara , unë preferoj të përdor termin aftësi ndryshe është më pak diskriminuese. Brenda strukturës së njësisë funksionojnë 3 shërbime sipas tipologjisë me një personel të përbashkët administrativ. Qendra e zhvillimit rezidencial ndryshoi emërtimin në qendër zhvillimi , nga qendër zhvillimi në shtëpi përkujdesi për personat me aftësi të kufizuar të braktisur dhe pa përkujdesje, qendra ditore e zhvillimit të ndryshojë emërtimin nga qendra ditore e zhvillimit në qendra ditore atelier. Fondet që financohen nga buxheti i shtetit për dy qendrat e zhvillimit në Korçë ti kalojnë bashkisë si fond i dedikuar për funksionimin e njësisë. Bashkia të vazhdojë të buxhetojë me fonde për njësinë i cili do të mbulojë shpenzimet për mirëmbajtjen e infrastrukturës, për aktivitet, automjete, karburante etj. Njësi e monitorimit të shërbimeve shoqërojnë drejtorinë e kujdesit social në bashki dhe monitorojnë zbatimin e standarteve të shërbimeve për njerëzit me aftësi ndryshe të miratuara nga VKM nr.822 datë 06.12.2006 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve për kujdesje për personat me aftësi të kufizuar në qendrën rezidenciale dhe ditore. I propozojmë këshillit bashkiak të bëjë miratimin e këtij relacioni bashkë me rregullimet strukturore, financiare apo dhe të funksionimit të këtyre njësive në kuadër të njësisë të shërbimeve të specializuara.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga ekzekutivi ka diçka për të shtuar?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Mund të them diçka unë në mënyrë të detajuar. Pra siç u tha dhe nga profesorja momentalisht janë 3 struktura në funksion të shërbimit për personat me aftësi të kufizuar në qytetin e Korçës, është qendra rezidenciale e zhvillimit, qendra ditore e zhvillimit dhe qendrakomunitare për fëmijët deri 18 vjet. Momentalisht këto 3 qendra funksionojnë si njësi më vete, dy të parat janë institucione më vetë në varësi të bashkisë , ndërkohë që struktura e tretë funksionon si një strukturë brenda drejtorisë të kujdesit social. Kjo është përse i takon anës organizative, ndërkohë nga ana e buxhetit pra financimit pjesa më e madhe e kostove të këtyre qendrave financohet nga buxheti i shtetit, ndërsa një pjesë e kostove financohet nga ana e bashkisë. Ne kemi bërë një studim përpara pak kohësh për të parë se kush do të ishte mënyra më e mirë e funksionimit të shërbimit që bashkia duhet të ofrojë ndaj personave me aftësi të kufizuar dhe gjetjet e këtij studimi i paraqitur në ky material që po jepet sot dhe sugjerimi i ekspertës që të tre këto njësi të funksionojnë brenda një njësie të vetme, pra të jetë një njësi e përqëndruar dhe brenda saj të jenë 3 sektorë sipas këtyre institucioneve më lart, do të kenë një administrim të përbashkët dhe kjo do të krijojë jo vetëm mundësi për përdorimin eficient të fondeve por ajo që është më e rëndësishme është për koordinimin e ofrimit të shërbimit. Një fëmijë që është klient i kësaj shërbime komunitare për fëmijët deri 18 vjet idealisht do të mundeshe që pastaj që një

pjesë të shërbimeve ti merrte edhe tek qendra ditore ku mund të kryente antarësimin në një kurs dhe të të merrte një lloj aftësie, e njëjta gjë vlen edhe në raport me këtë qendër rezidenciale të zhvillimit, pra për të krijuar një lloj sinergjie në aktivitetin e secilës prej këtyre njësive me qëllim arritjen e asaj që është edhe qëllimi final ofrimi i një shërbimi më të koordinuar ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ajo që po kërkojmë sot është një miratim në parim ky ndryshimi organizativ dhe pastaj do të ndjekim hapat dhe konsultimet edhe me drejtorinë e shërbimit social shtetëror dhe ministrinë e shëndetësisë dhe mirëqënies sociale për të arritur qëllimin përfundimtar e këtij procesi që duam ta startojmë sot, i cili besoj do të duhet të realizohet me anën e një vendimi të këshillit të ministrave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT, "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË."

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj, znj.Gerla Koleci, znj.Maria Dojçe, znj. Silvi Tare, znj.Etleva Tare, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Joan Deli.

Këshilltare I.Nikaj: I propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e relacionit për programin social të strehimit përmes subvencionimit të interesave të kredisë i cili është një program strehimi që vazhdimisht funksionon dhe u shërben familjeve, individëve që nuk janë në gjëndje ekonomike sociale të përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave apo kredive hipotekore. Në rastin e miratimit të listës të familjeve që përfitojnë këtë, kredia është me interes jo më të lartë se 3% dhe me afat maksimal 30 vjet, mbështetur në bazueshmërinë ligjore që është përcaktuar në relacion ligji nr.139 i vitit 2015 për vetëqeverisjen vendore. Për strehimin social ligji nr.22 I vitit 2018 Vendimi i KM 384 datë 12 qershor 2019 " Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet t'ju paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore. VKM nr.301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit si dhe ato që lidhen me VKB për miratimin e sistemit të pikëzimit dhe aplikantët për fazën e dytë kanë fituar 7 familje. Sipas listës që i është bashkëngjitur këtij relacioni me të dhënat përkatëse, vlerën maksimale të apartamentit dhe cilësitë që janë përcaktuar në kuadër të sistemit të pikëzimit. I propozoj këshillit bashkiak miratimin e këtij relacioni.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga ekzekutivi ka diçka për të shtuar?

Ekzekutivi M.Balli: Ne do të vazhdojmë të sjellim listat për familjet që përfitojnë nga programet sepse kemi kuota të lira. Sot kemi paraqitur 7 familje, ato familje kanë plotësuar kriteret sipas kushteve sociale, kushteve familjare dhe kushteve ekonomike. Janë të përcaktuara me ligj kriteret tek programi i subvencionit të interesave të kredisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Sa është kuota aktualisht? Kuota e papërdorur?

Ekzekutivi M.Balli: Në informacionin që kam unë , në shpërndarjen e banesave deri në 30 shtator janë ezauruar 53 kuota, pra ka të bëjë më rimbursimin e kredisë, kush ka lidhur kontratë me bankën, kështu që kuota të lira kemi rreth 80.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëhere meqënëse ky muaj është edhe muaji i fundit i vitit kryetari mund ta përdorë këtë për të bërë thirrje, të vazhdojnë aplikimet , ne nuk ka nevojë të presim fundin e muajit dhjetor për të marrë një vendim po qe se ka të interesuar mund ta bëjmë dhe javën e parë të dhjetorit ose javën e dytë. T'ju krijojmë mundësi sepse sot mendoj është më me interes për qytetarët ky program për shkak të ndryshimit të normave të interesave.

Ekzekutivi M.Balli: Kërkesa ka, por kanë vështirësi në plotësimin e dokumentacionit me çfarë shikoj. Këtu kërkesa kemi ne të akumuluar por duhet të plotësohen dokumentat.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: I keni njoftuar?

Ekzekutivi M.Balli: Patjetër, sapo të kemi përsëri aplikime.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ideja është këtu nuk duhet të presim fundin e muajit sepse s'ka vlerë një vendimmarrje e marrë në fund të dhjetorit , qoftë edhe 2-3 familje apo 1 familje të bëjmë mbledhje.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit tëditës

PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2023.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria-Dojçe

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Fjalën e ka kryetari i bashkisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do të vazhdojmë të mbajmë në fuqi edhe gjatë vitit 2023 një pjesë të madhe të lehtësive fiskale që i kemi paraqitur dhe i kemi miratuar edhe për vitin 2022. Po I lexoj shkurtimisht, do të lehtësohet 20% vlera e tarifave vendore për bizneset që kanë mbi 20 persona të punësuar gjatë vitit ushtrimor, do të përgjysmohen tarifat vendore për subjektet që kanë mbi 50 punonjës të punësuar dhe do të përjashtohen krejtësisht nga tarifat lokale subjektet që kanë mbi 100 punonjës të punësuar. Këto janë 3 lehtësi fiskale që ne i kemi propozuar për të nxitur punësimin dhe një lehtësi fiskale që u bëhet bizneseve për të punësuar një numër të caktuar personash dhe gjykojmë që është një masë që do të nxisë punësimin dhe nga ana e këtyre bizneseve. Do të përjashtohet nga pagesa e hapësirës publike për muajt dhjetor janar shkurt, përjashtohet nga pagesa e taksës të ndërtesës familjet që përbëhen vetëm nga pensionistë, përjashtohen nga pagesat e tarifave lokale familjet që përbëhen nga 1 pensionist dhe familjet kryefamiljari i të cilave përfiton ndihmë ekonomike, përjashtohet nga pagesa e tarifave në vitin 2023 të gjitha subjektet që do të zhvillojnë për herë të parë aktivitet dhe do të regjistrohen si të tilla pra si aktivitete biznesi nga studentë të diplomuar në universitet brenda dhe jashtë vendit gjatë viteve 2022-2023, përjashtohet nga pagesa e tarifave për vitin 2023 të gjitha subjektet që do të regjistrohen dhe do të ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e artizanatit, përjashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2023 të gjithë investitorët e huaj që do të hapin dhe zhvillojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në bashkinë e Korçës, përjashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2023 të gjitha subjektet që do të regjistrohen dhe do të ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e teknologjisë të informacionit dhe të komunikimit, aktivitetin e tyre në fushën e institucioneve arsimore private, si dhe ato subjekte që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e arsimit privat plotësues dhe joplotësues, organizimit të trajnimeve, kualifikimeve në fusha të ndryshme profesionale. Përjashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2023 të gjithë fermerët që janë regjistruar me nipt të fermerit dhe përjashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2023 të gjitha organizatat jo fitimprurëse që do të regjistrohen dhe do të ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në bashkinë e Korçës gjatë vitit 2023. Krahas këtyre lehtësirave fiskale ka dhe disa ndryshime të tjera që propozohen në paketën fiskale. Një ndryshim i takon pjesës të tarifave që do të aplikohen në funksionimin e tregut së gjëse së gjallë. Ju e dini që para pak muajsh ka filluar nga funksionimi tregu i ri i gjëse së gjallë në bashkinë e Korçës. Është një treg icili synon të ofrojë standartet bashkëkohore të tregëtimit të bagëtive në bashkinë tonë duke siguruar kushte më të mira jo vetëm për shitësit dhe blerësit por edhe plotësim të standarteve ushqimore sidomos për produktet blektorale. Jemi shumë të kënaqur me atë se si ka funksionuar tregu në këto javë të para të funksionit të tij ndërkohë tani është duke u zbatuar në këtë treg dhe një fazë e dytë investimi i mbështetur në fonde të AZHBRS pra të ministrisë së bujqësisë. Po duke nisur nga eksperiencia e këtyre javëve të funksionimit propozohen që të ketë disa ndryshime në tarifat që aplikohen si dhe propozohen që ushtrimi I aktivitetit në këtë treg nga një herë në javë të kryhet dy herë në javë dhe besoj që me këtë mënyrë funksioni dhe me këto të ardhura që ne do të grumbullojmë nga tarifat që do të aplikojmë do të kemi mundësi që aktiviteti në këtë treg të jetë i qëndrueshëm edhe të vazhdojë të ushtrohet me standartet që ne duam që ky treg të plotësojë. Ndryshimi i dytë parashikohet në tarifat por dhe në përdorim të sallës të galerisë të bibliotekës Thimi Mitko dhe tarifës që përdoret për dhënie në

përdorim të sallës të konferencave, pra janë dy ambiente të kësaj biblioteke si dhe ka disa ndryshime, riformulime dhe plotësime që ne po i bëjmë zëra të caktuar të paketës fiskale dhe më tepër për të bërë saktësimin se ku dhe çfarë aplikon secili nga zërat e kësaj pakete pasi ka patur raste mund të shpjegohet nga drejtoria e të ardhurave ku ka pasur çështje të interpretimit që një shërbim apo një funksion i caktuar ku duhet të klasifikohet dhe me këto eksperiencë po i reflektojmë tani më paketën fiskale me qëllim që çdo gjë të jetë e përcaktuar dhe e saktësuar. Ky është një kuadër i përgjithshëm i paketës fiskale të këtij viti, të vitit që vjen domethënë, vitit 2023. Nuk e di nga ana e drejtorisë së të ardhurave Soni nëse mund të shtosh diçka.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka? Komisioni ka diçka për të shtuar?

Këshilltari I.Nikaj: Unë kam një pyetje në lidhje me lehtësimet fiskale që janë parashikuar, do të doja të dija sa është numri i bizneseve, në numër dhe % që përfitojnë nga 3 kategoritë e përjashtimit që janë të përmendura, si vete si numër?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Soni i ke shifrat?

Ekzekutivi S.Prifti: Në lidhje me kategoritë e bizneseve nuk është se është numri i madh realisht. Në lidhje me 20 % janë 51 subjekte, për përgjysmimin e tarifave janë 17, dhe për përjashtim janë vetëm 7.

Këshilltari I.Nikaj: Në përgjithësi sa është numri i bizneseve që operojnë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Sipas klasifikimit dhe sipas numrit të të punësuarve bizneset mbi 20 dalin rreth, përfshirë dhe ata të tjerët kur themi mbi 20, pra 51 ishin mbi 20 të punësuar por më pak se 50, pra në total mbi 20 sa biznese ishin? 51 + 17 që janë të përgjysmuara +7 pra në total 75 biznese. Pra 75 biznese janë mbi 20 punonjës.

Këshilltari I.Nikaj: Unë do të doja të bëja një sugjerim nëse ka në lidhje me çështjen e përdorimit sidomos të taksave. Do të doja të ishte më shpejtë puna për të përmisuar sidomos ndryshimet në infrastrukturë që bëhen nga ndërtimet. Kam vënë re dhe vazhdoj të vë re që është relativisht e ngadaltë. Ne marim një taksë me ose merr bashkia një taksë në të cilën duhet ta përdorim me më shpejtësi dhe efikasitet që infrastruktura rrugore most ë jetë në atë gjendje që është. Unë besoj që ju të gjithë e keni vënë re se sa e dëmtuar është kjo nga ndërtimet, nga ndërhyrjet, nga kanalizimet, të cilat normalisht kanë detyrimin të kthehen në gjendjen e mëparshme, por është e vështirë ta gjesh të tillë këtë përmirësim ose ndërhyrje.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët e tjerë ka diçka? Ekzekutivi ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës.

"PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË TË NJË PJESE TË PASURISË NR. 4/78 ZK 8564 NDËRTESE SIPAS PLANVENDOSJEVE BASHKANGJITUR."

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Relacion për fillimin e procedurave për transferimin në pronësi të bashkisë Korçë të një pjese të pasurisë nr 4/78 ZK 8564, ndërtesë sipas planvendosjeve bashkangjitur. Bazuar në një vendim të vitit 2008, bashkisë Korçë janë transferuar një pjesë e pasurisë së paluajtshme në pronësi. Në këto forma të transferuara bënë pjesë pasuria 4/78 ZK 8564, që përmendëm dhe ndodhet pranë terminalit të autobusave pra bëhet fjalë për ish hipotekën. Në kuadër të investimeve që kryen bashkia ka për qëllim të realizojë me këtë pasuri përmbushjen e funksioneve të saj ligjore. Në funksion të zhvillimit të pjesës pranë terminalit bashkia kërkon që kjo pronë të transferohet në pronësi të bashkisë dhe kërkon fillimin e procedurave për realizimin e transferimit. Nga këshilli bashkiak kërkohet dhënia e autorizimit për transferimin e pasurisë në pronësi të bashkisë.

Kryetar i bashkisë S. Filo : Një pjesë e ish hipotekës, jo e gjitha. Bëhet fjalë për një pjesënë kufi të pronës që na është transferuar ne, ish uzinës të instrumentave dhe pjesës që i ka mbetur hipotekës. Normalisht nga ana e funksionit është një pronë që duhet të ishte nga ana jonë se gjysma është këtej e gjysma është andej. Tani po kërkojmë atë gjysmën e kësaj prone me qëllim që të bëhet funksionale kjo pronë, jo pjesa tjetër e ish zyrave të hipotekës, një pjesë që është gjysma këtej gjysma andej. Nga ana e funksionit duhet të ishte këtej, nga ana e vlerave një pjesë ka ngelur andej.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Kush e ka atë pronë?

Ekzekutivi A. Dishnica: Ajo është shtet.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Cili ent e ka?

Kryetar i bashkisë S. Filo : Ministria e Drejtësisë

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Ka diçka nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës.

"PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË TË PASURIVE NR. 104/5 dhe 104/2 ZK 1538 ME VENDNDODHJE NË ISH VASKAT E PESHKUT DRENOVË, SIPAS PLANVENDOSJEVE BASHKANGJITUR."

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Bëhet fjalë për transferimin në pronësi të bashkisë të pasurisë nr104/5 me vendodhje në ish vaskat e peshkut në Drenovë. Kjo pronë duhet nga bashkia për të finalizuar investimet dhe bëhet fjalë për pasurinë që ndodhet në ZK 1538 me sip 176 512m dhe pasuri nr 104/2 ZK 1538 . Edhe këtu kërkohet dhënia e autorizimit nga ana e këshillit të bashkisë për të filluar procedurat për kalimin e pronësisë.

Kryetar i bashkisë S. Filo :Në rast se mund të shtojë diçkabëhet fjalë për një zonë të cilën bashkia synon ta shndërrojë në një zonë ekonomike në funksion të zhvillimit ekonomik të vendosjes së bizneseve të ndryshme të manufakturës kryesisht. Kemi marrë disa kërkesa nga disa kompani të cilat janë duke shqyrtuar mundësinë e zhvendosjes të hapjes së fabrikave të tyre në qytetin e Korçës, dhe të dy kompanitë apo kompani të tjera që mund të vijnë më vonë kërkojnë që ne ti vemë në dispozicion në rast se kemi troje publike për qëllim të ngritjes së linjave të tyre të përpunimit. Kjo zonë edhe në planin e përgjithshëm vendor të bashkisë Korçës është përcaktuar si zonë industriale, për aktivitete ekonomike. Ajo që ka ngelur si pikë problematike është statusi juridik i kësaj prone. Në këtë material të sotëm ne i japim rrugë kërkesës pranë qeverisë shqiptare për të na i kaluar në pronësi të bashkisë dhe në këtë moment do të jemi në gjendje ti ofrojmë sipas kuadrit ligjor ekzistues këtyre kompanive apo kompanive të tjera që do të duhen të vendosen në qytetin e Korçës.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Kjo planvendosja Anxhela këto zonat që janë 104/3, 104/4.

Ekzekutivi A. Dishnica: Ato janë përjashtuar nga sipërfaqja që ne kërkojmë të na transferohet.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Ka diçka nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27
Vota KUNDËR 0
Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE DHE PLANIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE TË KËSHILLIT BASHKIAK PËR VITIN 2023.

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Kjo pikë ka të bëjë me aktivitetet e këshillit. Tani në duhet të marrim vendim për ata që do të vinë por më mirë ti kenë gati.

Sekretare E. Naçi: Kjo është bazuar dhe në rregulloren e këshillit.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Mbase do të kenë mundësi ti zhvillojnë në mënyrë dhe më të plotë. Meqënëse jemi në këtë pikë doja tju thoja që ne jemi në përfundim të mandatit 4 5, mbledhje na takon të bëjmë. Do ju ftoja, kërkoja që të respektojmë këtë mandat deri në përfundim të këtij. Prezenca sot pavarësisht dhe rëndësisë të materialeve prezenca që më e plotë se herët e tjera. Shpresoj që në mbledhjet e ardhshme dhe ata që s'kanë qënë sot të jenë prezent dhe të respektojnë mandatin e dhënë. Kjo ka nevojë të votohet?

Sekretare E. Naçi: Po.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Përpara se të kalojmë te pika e 10 e informacionit, trajtojmë dhe ankesat, kërkesat e qytetarëve. Janë paraqitur nga qytetarët disa ankesa, kërkesa, janë shpërndarë 3 prej tyre. Një kërkesë është një peticion drejtuar këshillit bashkiak por kam përshtyjen që kjo vlen dhe për ekzekutivin pavarësisht se koka e shkresës është për këshillin bashkiak. Ka qytetarë për këtë material?

Sekretare E. Naçi: Janë këtu poshtë.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Ju jeni përfaqësi e peticionit. Titulli i peticionit është për krijimin e fondit të komitetit për bashkëfinancim dhe investimit të termoizolimit të bansave në masën 50% nga fondet publike.

Qytetare Ola Mitre: Unë jam Ola Mitre, jam drejtore ekzekutive e organizatës All Green Center. Është një organizatë që fokusohet te çështjet mjedisore dhe peticioni që ne paraqesim sot e ka zanafillën si pasojë e problematikës që ne kemi konstatuar në qytetin e Korçës gjatë stinës së dimrit si pasojë e përdorimit të lartë të druve të zjarrit që përdoren jo vetëm për ngrohjen por edhe për gatim. Paraprakisht ne kemi realizuar vlerësime konkrete se si termo izolimi si një nga masat e eficensës së energjisë mund të reduktojë konsumin e energjisë që ne këtë rast janë drue

të e zjarrit dhe për pasojë duke ulur konsumin e druve të zjarrit ne rrjedhimisht ulim edhe emetimin e ndotësve të ajrit. Ne rrjedhimisht kemi marr një banes në studim në lagjen 17 të aytefit të Korçës, ka qënë një apartament 3+1, me një sipërfaqe realtivisht të madhe 90 m2 dhe pasi kemi simuluar dhe kemi kryer të gjitha matjet në këtë banesë kemi rritur në konkluzionin, është edhe eksperti i auditimit të energjitë që ka kryer të gjithë vlerësimin. Kemi arritur në konkluzionin që nëse në këtë banesë do të kryhen ndëryhrjet termoizoluese atëherë do të reduktohet konsumi i druve të zjarrit me 67%, pra praktikisht për shkak të karakteristikave që paraqet termoizolomi ulet rrjedhimisht edhe sasia e druve të përdorur, normalisht dhe emetimi i ndotësve të ajrit në ajër ulet po në të njëjtën sasi. Pra praktikisht do të kemi 67% më pak ndotje, nga ana tjetër përfitimet janë të mëdha në mjedisë në drejtim dhe të ndotjes së ajrit. Normalisht do të nevojitet më pak lëndë drusore e njëjta sasi pra 67 % më pak, dhe benefitet nga pikëpamja mjedisore janë shumë të mëdha, nga ana tjetër janë dhe përfitimet për jetesën e qytetarëve sepse një banesë e termoizoluar paraqet një konformitet shumë të madhe në banesë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Patjetër që termoizolimi është shumë i rëndësishëm, të lutem në lidhje me peticionin , pse kjo zonë për shembull dhe jo një zonë tjetër .

Qytetare Ola Mitre: Ne kemi zgjedhur lagjen 17 për shkak të përqëndrimit që ka në numër pallatesh duke qënë se është një zonë që kryesisht ka të përqëndruar më shumë pallate sesa banesa private dhe duke qënë se fondi i komunitetit një model që është përdorur dhe në bashkinë e Tiranës ku banorët financojnë 50% nuk është një detyrim por është një parashikim ligjor që e parashikon këtë masë. Ne kemi zgjedhur lagjen 17 për shkak të numrit të madh të pallateve dhe do të donim që kjo të fillonte pikërisht nga lagjia 17 duke qënë se dhe impakti nëse fillohet që atje do të jetë më i madh sepse ka më shumë pallate, nga ana tjetër përveç peticionit ne për ti lehtësuar ndoshta dhe punën e bashkisë që mund të bëjë më tepër, dhe këshillit bashkiak duke nisur nga problematikat që është hasur në bashkinë e Tiranës si pasojë e këtij modeli sepse shpeshherë duke qënë se pallatet kanë disa apartamente dhe nevojitet dhe dakordësia e banorëve për këtë projekt ne ju kemi paraqitur, është bashkëlidhur peticionit edhe një marrëveshje dakordësie. Kemi identifikuar dy pallatet e parë ku banorët janë të gatshëm që nëse bashkia vendos fondin në dispozicion për të mundësuar 50% të financimit ata janë të gatshëm që 50% të vlerës ta paguajnë vetë sikursë është edhe praktika e fondit të komunitetit. Pra ne kemi lehtësuar këtë pjesën proceduriale duke dhënë zanafillën se ku mund të fillojë aplikimi i këtij procesi që normalisht mund të fillojë nga diku por më tej do të dojë edhe procedura të tjera, edhe një shtrirje në kohë sepse normalisht numri i pallateve në qytetin e Korçës është relativisht i lartë dhe duke marrë në konsideratë edhe kapacitetet financiare që mund të këtë bashkia që është edhe një diskutim që ne mund ta argumentojmë edhe me ekspertin e ekonomisë cili bëri edhe analizën financiare të kapaciteteve buxhetore të bashkisë sepse e dimë që bashkitë në Shqipëri kanë probleme me pjesën e sigurimit të financave por ne me analizën që kemi realizuar ndoshta eksperti mund të bëjë një prezantim më të detajuar se cilat janë hapësirat buxhetore që i mundësohen bashkisë për të financuar duke nisur fillimisht nga këto dy banesa që ne kemi paraqitur në peticioni.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ne vitin e kaluar kishim një fond që nuk u shfrytëzua apo jo, 5,000,000 lekë të reja dhe nuk u shfrytëzua.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Patjetër që në projekt apo në disa projekte që do të synojmë ti japim një zgjidhje përfundimtare të ngrohjes të qytetit të Korçës për mua do të ishin projektet më i madh dhe kryesor në pjesën e investimeve në infrastrukturë. Tani që Korça është i vetmi qytet në

shqipëri apo nga të paktët se mund të jetë edhe ndonjë tjetër që ka zgjedhur furnizimin me ujë të pijshëm për 100% të qytetit, rikonstruksionin e rrjetit të kanalizimeve, çështjen e menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Projekti i rradhës është zgjidhja e problemit të ngrohjes. Tani kjo i ka brenda dy drejtime kryesore, e para është identifikimi i burimeve alternative të ngrohjes pra jo drutë e zjarrit që shkaktojnë ndotje mjedisore për faktin që digjen dhe krijojnë tym pasi digjen pa asnjë lloj filtrimi, pra alternativat lëndët djegëse që duhet të përdoren nga ana e popullatës dhe e dyta është aplikimi i masave të efikasitetit të energjisë që do të sjellin një konsum të energjisë që kërkohet për të ngrohur banesat e qytetarëve të qytetit të Korçës. Ne jemi duke punuar paralelisht për të dy këto drejtime, për drejtimin e parë pra alternativat për ngrohjen e qytetit kemi një lajm shumë të mirë që është mundësia e përdorimit të gazit natyror duke përfutur edhe nga fakti që jemi në afërsi të tubacionit të tapit. Ju besoj i keni ndjekur lajmet dhe keni parë që dhe në bisedimet e zhvilluara ndërmjet qeverisë Shqiptare dhe asaj të Azerbajxhanit, bashkia e Korçës është paraqitur nga ana e qeverisë Shqiptare si projekte të rëndësishme nga do të duhet të fillojë gazifikimi i vëndit dhe unë ditën e mërkurë do të kem takim me drejtuesit e kompanisë Albgas që është kompania shqiptare shtetërore e gazit dhe përfaqësues të kompanisë të konsulencës për të ecur konkretisht me projektin e gazifikimit të qytetit të Korçës që është një lajm shumë i mirë për qytetin. Drejtimi tjetër është aplikimi i masave të efikasitetit të energjisë nëpërmjet termoizolimit të godinave private dhe publike. Edhe për këtë jemi duke punuar. Ju vetë e keni parë që jemi duke folur janë 8 pallate në të cilat ka filluar aplikimi i termoizolimit si një kërkesë e bashkisë të Korçës dhe si një financim i fondit Shqiptar të zhvillimit dhe këtë projekt tani duam ta shtrijmë në të gjithë Korçën. Kuptohet që nuk na mjafton vetëm dëshira, duhet edhe burimet e financimit që janë të konsiderueshme. Kemi menduar edhe për këtë dhe njëra prej alternativave tona do të jetë investimi nga ana e bashkisë në një park fotovoltaik në pronësi të bashkisë. Të ardhurat nga shitja e energjisë të cilat do të përdoren pjesërisht për të shlyer investimet në ndërtimin e këtij parku dhe pjesërisht për të hyrë në një fond që do të përdoret nga ana e bashkisë për të financuar ose bashkëfinancuar projektet e termoizolimit të pallateve të qytetit të Korçës. Përsa i përket projektit të propozuar konkretisht, një iniciativë të tillë e kemi patur edhe para 2 viteve. Në vitin 2020 kemi lënë një fond të dedikuar për të bashkëfinancuar projekte të termoizolimit me vlerën 5,000,000 lekë të reja i cili fatkeqësisht nuk është përdorur, pasi kemi dështuar ti identifikojmë ose nuk na janë paraqitur aplikime të subjekteve të sukseshme të tipit që banorët e pallatit të ishin organizuar ashtu sikundër e parashikon edhe ligji në asamblëtë e bashkëpronarëve të përcaktonin një administrator, të vinin në dispozicion edhe 50% të vlerës të investimit dhe ne me shumë dëshirë do të vinim në dispozicion 50% të pjesës tjetër të investimit. Pra nuk është arritur dhe është një sfidë goxha e madhe dhe nuk është e lehtë nga eksperiencia ime që ti bindësh banorët që të organizohen në këto asamblëtë e bashkëpronarëve dhe të bashkëfinancojnë në këto projekte. Kështu që jam shumë i kënaqur që ju keni arritur të identifikoni dy pallate, por të shkojmë së bashku pak më tej dhe këto firmat ti përkthejmë në hapa ligjorë, pra të ngrihet sipas përcaktimeve të ligjit asamblëja e bashkëpronarëve në këto dy pallate, të caktojnë administratorët, të bien dakord për të bashkëfinancuar 50% dhe ne po ja u them që tani që do ta kemi mundësinë që vitin që vjen ti bashkëfinancojmë 50% të pjesës tjetër të investimit. Kërkojmë bashkëpunimin nga ana juaj në pjesën e formalizimit të asambleve të bashkëpronarëve si hap i parë dhe pastaj në momentin kur ne do të kemi miratuar buxhetin tonë pastaj edhe angazhimi i familjeve për të bashkëfinancuar 50% e pjesës tjetër.

Qytetari: Pa ju marrë shumë kohë, faleminderit që na pritët dhe na latë të shprehim këtë iniciativë që ka ardhur jo vetëm nga Ola por edhe nga pjesëmarrës të kësaj nisme të cilët kanë firmosur tashmë. Unë kam qënë në marrëdhënie pune me bashkinë Korçë, nuk mund të flas për

eksperiencën time por kisha bindjen e plotë që ne do të gjenim hapësirë. Për të ndaluar edhe tek fondi në këto 24 apartamente që ne kemi konstatuar fondi 5,000,000 lekë është mëse i mjaftueshëm. Unë shpresoj që gjithcka të realizohet dhe padyshim Ola do të gjejë të gjitha burimet e disponueshme për të arritur këtë dhe për ta bërë të realizueshme.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani gadishmëria jonë patjetër nuk do të mungojë, unë e thashë vetë e keni për qytetin e Korçës për mua projekti i parë madhor infrastrukturor është zgjidhja e ngrohjes si me alternativën e lëndës djegëse ashtu dhe me masat e efikasitetit të energjisë. Ky është kryesori për mua, kështu që angazhimi im nuk duhet të mungojë. Tani duhet të punojmë të gjithë sëbashku dhe të krijojmë disa modele pozitive të bashkëpunimit bashki banorë, dhe të shpresojmë pastaj që këto modele pozitive do të inkurajojnë edhe të tjerë ti bashkëngjiten dhe të fillojnë ata të krijojnë këto asambltë dhe të angazhohen për bashkëfinancim. Ne do jemi në gjendje të mbështesim të gjitha rastet që do të na paraqiten.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Edhe unë doja t'ju falenderoja në fakt për iniciativën, edhe zona pavarësisht se pyetja ime ishte në kontaktin e mbështetjes, lagjia 17 mbase shumica e pallateve atje nuk janë të suvatuara, mund të jenë shumë pak mbase 10%.

Qytetarja: Ky ishte dhe qëllimi pse u zgjodh ajo lagje.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Dhe atje një pjesë nuk është vetëm efikasiteti e energjisë por për mua kjo ndërhyrje duhet të shoqërohet dhe me pjesën e izolimit të terracave sepse një pjesë e pallateve atje kanë shumë probleme që kanë çuar deri në degradim të apartamenteve të kateve të fundi. Me shifrat nuk po merrem sepse unë nuk jam për shifrat në këtë moment. Parimin pastaj sa % e përcakton eksperti.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Do të fillojmë me këto dy pallatet meqenëse keni arritur dakordësinë në bashkëpunim me strukturat tona të fillojmë ta formalizojmë. Është shumë e rëndësishme formalizimi sipas ligjit. Po ti pyesësh të gjithë thonë dakord, tani hajde formalizojeni dhe kjo pastaj do ti vlejë jo vetëm këtij projekti por do ti vlejë edhe problematikave të tjera që kanë pallatet sepse kanë shumë problematika të menaxhimit të hapësirave të përbashkëta sepse vijnë për shkak se nuk ngrejnë këto strukturat dhe të kenë atë angazhimin që duhet të kenë për ti mirëmbajtur këto hapësira të përbashkëta. Dhe dhe ta kuptojnë pak edhe banorët që bëhet fjalë për banesa private me bashkëpronësi.

Qytetare Ola Mitre: Ne në fakt e kemi hedhur me marrëveshjen që kem depozituar sepse banorët kanë zgjedhur një përfaqësues është e përcaktuar, që të ndjekë të gjitha procedurat e mëtejshme sepse dihet që do të ketë procedura të tjera.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Të shpresojmë që do të ecim deri në fund.

Zv kryetar i bashkisë K.Kita: Nga eksperiencia jonë ky është hapi më i lehtë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Nuk ka rëndësi, të shpresojmë që do të ecim.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar? Ne në këto moment nuk kemi qënë në stadin që na mungojnë lekët, ne kemi qënë në stadin që kemi lekë dhe nuk janë konsumuar sepse nuk arrihet që të finalizohet nga ana e banorëve. Në shumë banesa në Korçë 30% të paktën nuk jetojnë atje, pra ka vështirësi në këtë pjesë.

Qytetare Ola Mitre: Ne e kemi bërë bashkëfinanciar sepse kemi ndërgjegjësuar qytetarët që përveç investimit fillëstar, ai është një investim që kthehet relativisht në një kohë relativisht shumë të shkurtër dhe ndërkohë pastaj shfrytëzohet i gjithi.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Faleminderit atëherë, shpresojmë që të funksionojë. Ndonjë qytetar, kemi Gjergji Lubonjën i cili ka drejtuar një kërkesë mirëpo çështja është që Gjergji donte ta paraqiste vetë këtu. Të lutem Gjergji mundet?

Qytetar Gjergji Lubonja: Unë kam një kërkesë, kërkesën e kam bërë institucionit të prefekturës për t'i vendosur një shkollë emrin e xhaxhait tim.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Si procedohet në këto raste?

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Të na vini në dispozicion e para dhe ka shkollë pa emër në qytet dhe fshat ku janë . Është komisioni përkatës.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Më fal bëhet fjalë për në qytet Gjergji? Tani ideja është që përgjithësisht këto emrat e shkollave në qytet janë në vënë, në dijeninë time nuk ka ndonjë shkollë që të jëtë pa emër. Nëpër fshatra mbase mund të kemi por për pjesën e fshatrave duhet të kalojë diskutimi edhe në nivel lokal pasi fshatrat preferohen që të jenë figura që janë të lidhura me historikun e fshatit. Kështu që në këtë kuptim mbase duhet një informacion pak më i detajuar për xhaxhain, përveç faktit që ka qënë dëshmor ku ka ushtruar ndonjë aktivitet të tij. Është një kërkesë informacioni? Dakord ta shohim këtë, unë në parim nuk është se kam ndonjë kundërshtim përse më takon mua.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Si përfundim si e latë se Gjergji më takon mua pastaj, ta sqarojmë që këtu.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Si përfundim ajo që mund të bëjmë ne, Kletjon të lutem një listë me shkollat që janë të pa emërtuara pastaj do të duhet të gjykohet nga ana e komisionit tuaj se nëpër fshatra nuk mund të shkosh dhe të thuash do ta ve emrin kështu sepse del ai dhe thotë kemi filanin nga fshati ynë që ka dhënë kontribut.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Kemi një kërkesë kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak. Unë e nënshkruara Erjola Ramazan Rapce, banuese në fshatin Bulgarec e bëj këtë kërkesë institucionit tuaj si familjare dhe në të njëjtën kohë si person fizik me aktivitet hotel si administratore e hotelit me qëllim që të ris kapacitetin e hotelit kam parashikur të hap dhe bar-restoranin. Problemi im qëndron tek furnizimi me ujë të pijshëm. Nuk e di nëse e keni parë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: E kam parë , ideja është që zonja kërkon të furnizojë me ujë objektin ku do të ushtrojë aktivitetin me një pus i cili ndodhet në një tokë private. Ja kam përcjellë kërkesën administratorit, i kam kërkuar të kontaktojë me zotërin që është pronar i tokës ku ndodhet pusi dhe ai nuk ka rënë dakord që ta lejojë furnizimin me ujë nga ky pus. Tani zonja këtu shkruan që është pus publik, por pus publik në tokë private nuk ka. Nuk është diçka që e administrojmë ne. Ai zotëria ku ndodhet pusi në tokën e tij, nuk do, nuk kemi cfarë i bëjmë i kemi kthyer përgjigje për këtë gjë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Do dhe një përgjigje nga ana jonë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Eva të lutem do kontaktosh me administratorin e njësisë të bulgarecit, përgjigjen që më ka dhënë mua t'ja përcillni dhe zonjës.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Tani kemi dhe një kërkesë tjetër organizata Drejtësi Sociale nga Riza Cerova nr.23 Tiranë. Kërkesë për mos zbatimin e gjobës 100% për qiranë e banesave sociale.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Bëhet fjalë për banesat me qira sociale për rastet që e thyejnë. Kemi numrin e kontaktit, i kemi bërë referencë edhe një baze tjetër ligjore apo thjesht.

Ekzekutivi M.Balli: Ka një masë për ata që nuk paguajnë në afat. Kanë një datë të vendosur në kontratë.

Kryetar këshillit E.Nexhipi: Kush vete në banesa sociale patjetër qëështë në nevojë, sepse nuk vete një qëështë mirë nga ekonomia por duhet të respektojnë dhe disa rregulla se tani po diskutoj si këshilltar jo si kryetar. Po qe se hapim këtë lojë me shkeljen e rregullave fillon historia, këta meqënëse janë si organizatë ti asistojnë ti mbështetin që të jenë brenda rregullave sepse precedenti. Kjo pjesë për mua si qëndrim personal ky, për pjesën e këshilltarit hajde e diskutojmë këtu jemi.

Ekzekutivi M.Balli: Unë do thoja diçka që dhënia e qirasë në këto banesa është edhe nën vlerën mesatare të qirasë të tregut.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Jo unë nuk u morra me vlera, u morra me parimin e të qënit brenda rregullave, se ata po qe se nuk e përballojnë dot duhet të shkojnë në një program tjetër që mund ta përballojnë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Këto familje kanë rënë dakord që ta paguajnë qiranë dhe tani nuk duan kamatë vonesë?

Ekzekutivi M.Balli: Unë nuk kam asnjë informacion dhe nuk e di se cilat familje janë ato. Në zyrën tonë nuk kanë ardhur. Thuhet që janë 5 familje por nuk kam dijëni se kush janë.

Këshilltare E.Tare: Këtu thuhet që janë 5 familje të cilat janë dakord për të paguar të gjithë detyrimin që kanë por nuk e paguajnë dot kamatë vonesën .

Kryetari i bashkisë S.Filo: Unë mendoj që nga ana e drejtorisë tuaj të kontaktohet kjo qëndra, që të kuptojmë njëherë cilat familje janë, sepse Mirela i njeh më mirë edhe problematikat e tyre, sepse mund të jenë raste që e kanë thënë disa herë këtë gjë. Duhet të dimë se kush janë, se rast pas rasti. Duhet kontaktuar kjo organizata, ti merret lista e familjeve, të kontaktohen familjet si e kanë situatën, të kuptohet çfarë bëhet.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Nga eksperiencia ime ka njerëz që vazhdojnë të dalin vazhdimisht nga rregulli.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Edhe unë jam pak skeptik.

Këshilltare E.Tare: Ajo ndodh për arsye të ndryshme, sepse mund të jenë dhe me ndihma ekonomike.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Edhe nga eksperiencia personale flas ata njerëz që duan të dalin nga rregulli, vazhdojnë të dalin nga rregulli. Prandaj janë rregullat. Ka një fatkeqësi, kanë probleme hajde të marrim një vendim ta mbështesim por jo të prishim rregullin. Ta mbështesim një rast konkret siç e kemi bërë këtu, për shkak të një fatkeqësie për shkak të një suate të caktuar, hajde

ta mbështesim si rast ose si raste, por jo të shkelim rregullin. Përderisa ka një afat ata ta respektojnë afatin.

Ekzekutivi M.Balli: Prandaj do ti kontaktojmë që të shikojmë çfarë problematike ka secila familje. Nëse ka një problematikë që e parashikon dhe ligji okay. Ne nuk e dimë se cilët janë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Si parim s' duhet të hapim preçedencë.

Këshilltare I.Nikaj: Jo vetëm kaq por nga kërkesa se duhet të kemi parasysh që kërkohet të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe kjo është kërkesa, kjo është ideja e kërkesës së parë, që në emër të respektimit të të drejtave duhet të kalojë kjo. Nuk ka lidhje.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Po s'kanë tani këta, kanë nga një shoqatë kanë nga një vulë hajde ecim.

Këshilltare I.Nikaj: Nëse edhe për atë që thotë Etleva si anëtare e këshillit bashkiak do të duhet që të vijë i plotë si material dhe pastaj ne të diskutojmë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Jo si parim nuk jam që të shkelim këto rregulla. Unë personalisht jam që ta mbështesim, ka një situatë ekstreme hajde ta mbështesim.

Këshilltare I.Nikaj: Në parim nuk thotë ndonjë gjë të madhe për atë që është.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Atëherë ka nga qytetarët diçka tjetër për të shtuar? Kemi dhe një material tjetër informacioni të cilin e lashë për në fund. Në diskutimet ka diçka për të shtuar.

Këshilltare I.Nikaj: Unë kam një sugjerim që lidhet me funksionimin e komisionit për akordimin e titujve. Pjesa që është e zgjedhur pra ata që janë anëtarë të jashtëm jo nga këshilli ka patur gjithmonë vështirësi për ti sjellë që të mund të figurojnë në vendimarrje. Unë do të sugjeroja që personat që i propozojnë këta njerëz të kenë edhe numra kontakti dhe ti kontaktojnë në mënyrë të tillë që të sigurojnë pjesëmarrjen dhe suksesin e mbledhjeve që ne përpiqemi të organizojmë. Në disa raste është bërë vështirësi dhe unë mendoj që duhet marrë vendimi i tyre pastaj duhet ti propozojmë që të jenë pjesë e këtyre komisioneve. Për pjesën e jashtme e kisha.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Atëherë që mos e lemë problemin pa emër, për ata që më është dashur të propozoj e kam bërë këtë procedurë dhe i kam marrë në telefon ju kam kërkuar miratim paraprak. Për ato emra ishte për shembull i mjekëve që duheshin për atë komisionin e doktor Kujtimit. Tjetër më thoni cili është emri konkret jo kështu në përgjithësi ju lutem. Profesor Nestin më duket se na i propozoi Pandi.

Këshilltare I.Nikaj: Kontaktova me Irenën dhe më tha unë nuk kam dijeni për këta personadhe përveç kësaj jam në Bulqizë. Duhet të përpiqemi që të mblidhemi prandaj e bëjmë atë sepse nuk them që nuk kemi edhe vendimarrje, nuk funksionon si vendimarrje, por është edhe e moralshme që ata duhen njoftuar.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Më fal kjo zonja nuk është njoftuar? Kush e propozoi si emër Irenën?

Këshilltare I.Nikaj: Unë e kontaktova dje dhe më tha që jam në Bulqizë, nesër jam në Mallakastër.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Tani edhe njëherë po qe se nuk është njoftuar.

Këshilltare A.Verushi: Është njoftuar, por nuk është.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Mirë pra ajo ka thënë që nuk di gjë.

Këshilltare I.Nikaj: Mua më tha që unë nuk e njoh aktivitetin e këtij personi.

Këshilltare A.Verushi: Atëhere mund të propozojmë se ne kemi marrë nga shkolla e maltës kemi vendosur profesor Nesti Treskën.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Ka emra plot për të propozuar, na u thanë këta të dy.

Këshilltar Sh.Kajmaku: Paraprakisht duhen takuar u duhet thënë se çfarë pune është çfarë do bëjmë dhe duhet marrë pëlqimi i tyre, sepse kështu njohim të tërë.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Nejse vendimarrja mund të jepet me 4 nuk është e detyrueshme me 5.

Këshilltare I.Nikaj: Them nga ana morale.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Hajde e zgjidhim këtu moralen , nuk e zgjidhim dot çfarë të bëjmë kështu janë gjërat. Gjërat nuk lihen kështu e fillojmë sot dhe e mbyllim për 6 muaj.

Sekretare E.Naçi: Ju lutem herën tjetër kur bëni propozim, këshilltari që do të propozojë të më japë në fund kontaktet.

Kryetar i këshillit E.Nexhipi: Ka dikush tjetër dicka tjetër përpara se ta mbyllim mbledhjen? Është informacioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të institucioneve arsimore.

Ekzekutivi J.Trasha: Komisionet e inventarizimit të krijuara me firmën e titullarit krijojnë një ndarjezim në të gjitha subjektet dhe detajojnë ato materiale të cilat nuk janë më të përdorshme në baze të disa karakteristikave. Duke zbatuar me përpikmëri udhëzimin hartojmë dhe listat të specifikuar në bazë të llogarive të kontabilitetit. Vlen të theksojmë se inventarizimi i shkollave u bë shumë i detajuar sepse kishte shumë materiale që kishin ngelur vetëm nëpër depot e shkollave të cilat kishin kaluar dhe kohën e tyre të përdorimit dhe ishin vjetëruar, kështu që detyrimisht ato dolën jashtë përdorimit. Në bazë të evidencave analitike të kontabilitetit jemi të detyruara të specifikojmë dhe ato materiale të cilat janë të riciklueshme ose jo. Ato që janë të riciklueshme kanë kaluar për vlerësim në specialistët përkatës për tu kaluar pastaj në procedurat e tjera të shitjeve në ankand. Kurse pjesa tjetër e materialeve drusore kanë kaluar nëpër shkollat të cilat kanë nevojë për lëndë djegëse si kaldaja me dru ose ngrohje me dru.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje? Faleminderit , e quaj mbledhjen e mbyllur.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

KRYETARI

ERJON NEXHIPI



